

# Statistikat e Transportit

## Shkurt, 2017

**Tiranë, më 28 Mars 2017:** Informacioni statistikor mujor mbi transportin, jep një panoramë të përgjithshme të ecurisë së transportit të mallrave dhe pasagjerëve me ajër, det dhe tokë (përfaqësuar nga transporti hekurudhor).

Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Shkurt 2017 është 274 mijë/ton. Krahasuar me Shkurt 2016, ky tregues është ulur me 3,0 %. Në portin e Durrësit janë ngarkuar/shkarkuar 92,7 % e mallrave të ngarkuar/shkarkuar në të gjitha portet.

**Tab. 1 Volumi i ngarkim-shkarkimit të mallrave në porte, Shkurt 2017**

(000/ton)

Periudha	Gjithsej	Durrës	Porte të Tjerë
Shkurt 2016	283	264	19
Shkurt 2017	274	254	20
Ndryshimi vjetor (%)	-3,0	-3,7	5,3
Janar-Shkurt 2016	526	483	43
Janar-Shkurt 2017	492	467	25
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-6,4	-3,3	-41,9

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë, (në ton/kilometër) është rritur 93,5 %, krahasuar me shkurt 2016. Në periudhën dymujore, rritja është 62,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

**Tab. 2 Transporti i mallrave me hekurudhë, Shkurt 2017**

Periudha	Volumi i mallrave 000/ ton.km	Volumi i mallrave 000/ ton
Shkurt 2016	666	4
Shkurt 2017	1.289	8
Ndryshimi vjetor (%)	93,5	100,0
Janar-Shkurt 2016	1.202	7
Janar-Shkurt 2017	1.958	11
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	62,9	62,5

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është rritur 7,7 %, në krahasim me Shkurt 2016. Në periudhën dy mujore, volumi i mallrave të transportuara është rritur me 6,4 %.

**Tab. 3 Transporti i mallrave dhe postës me ajër, Shkurt 2017**

Periudha	Mallra ton	Posta ton
Shkurt 2016	117	43
Shkurt 2017	126	41
Ndryshimi vjetor (%)	7,7	- 4,7
Janar-Shkurt 2016	236	86
Janar-Shkurt 2017	251	74
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	6,4	-14,0

Në transportin ajror operojnë 15 shoqëri fluturimi dhe janë kryer 1.554 fluturime ajrore, duke shënuar një rritje me 3,6 %, ndaj Shkurt 2016.


**Tab. 4 Treguesit e transportit ajror, Shkurt 2017**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Shkurt 2016	15	1.500	7.685
Shkurt 2017	15	1.554	7.435
Ndryshimi vjetor (%)	-	3,6	3,2
Janar-Shkurt 2016	15	3.152	16.330
Janar-Shkurt 2017	15	3.360	15.584
Ndryshim vjetor progresiv (%)	-	6,6	-4,6

Në Shkurt 2017, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është rritur 10,2 %. Transporti ajror i pasagjerëve zë peshën më të madhe me 76,5 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 43.176 persona, krahasuar me Shkurt 2016, ky tregues është rritur 5,7 %.

Fig. 1 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit , Shkurt 2017



Tab. 5 Transporti i mallrave 2007-2016

000/ton

Vitet	Transporti hekurudhor i mallrave	Transporti detar i mallrave	Transporti ajror i mallrave dhe Posta
2007	399	4.332	4
2008	355	4.705	3
2009	343	4.193	2
2010	403	4.170	2
2011	317	4.067	3
2012	142	3.984	2
2013	151	4.001	2
2014	338	4.067	2
2015	198	3.840	2
2016	76	3.756	2

**Tab. 6 Transporti i pasagjerëve, 2007- 2016**

000/pasagjerë

Vitet	Transporti hekurudhori	Transporti detar	Transporti ajror
2007	1.091	925	1.107
2008	822	1.080	1.260
2009	645	1.160	1.395
2010	430	1.120	1.537
2011	453	1.166	1.817
2012	448	1.101	1.665
2013	329	1.009	1.757
2014	187	1.095	1.810
2015	189	1.186	1.977
2016	69	1.289	2.139

# Metodologji

## Përkufizime:

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.*